



RAPORT VJETOR

PËR PUNËN E INSTITUTIT PARLAMENTAR PËR VITIN
2024

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	1
1. Shtëpi ligjvënëse e informuar	2
2. Kuvendi për të gjithë	6
3. Institut Parlamentar bashkëkohor	13
4. Parlament digjital	14

Përmbledhje

Në bazë të nenit 42 të Ligjit për Kuvendin dhe nenit 13 të Rregullores për punën dhe organizimin e Institutit Parlamentar, udhëheqësi i Institutit Parlamentar paraqet **Raport për punën për vitin 2024** para anëtarëve të Këshillit Drejtues. Në vitin 2024 Këshilli Drejtues mbajti **mbledhje më 17 janar 2024**.

Në funksion të informimit të deputetëve, në vitin 2024 u është dhënë përgjigje **45 kërkesave të parashtruara**; ka përgatitur **20 hulumtime** me iniciativë; dhe iu përgjigj **90 pyetësorëve** për rrjetet ndërkombëtare dhe parlamentet e tjera. Fond shtesë informacioni u sigurua me **5 materiale referuese** nga biblioteka; janë dhënë **82 tituj**; **4 baza të të dhënave të vëna** në dispozicion; **78 abonime** në Gazetën Zyrtare; 8 gazeta dhe revista; seancë hyrëse për të punësuarit e rinj të Shërbimit; një **trajnim për asistentët** e grupeve parlamentare në Kuvend.

Në funksion të hapjes së Kzvendit dhe komunikimit me publikun janë zbatuar këto aktivitete:

Në vitin 2024, **10.226 qytetarë** ishin pjesë e **230 vizitave të organizuara** të Kuvendit nga 39 vende të ndryshme banimi në shtet, prej të cilave 22 qytete të ndryshme dhe 17 nga mjedise të ndryshme rurale. Janë realizuar **30 seminare dhe punëtori edukative** gjithsej, kushtuar nxënësve të arsimit fillor dhe të mesëm, studentëve të universiteteve dhe mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm, me **gjithsej 822 pjesëmarrës**, ku morën pjesë **49 deputetë**.

Si aktivitete shtesë janë botuar dhe shpërndarë gjithsej **7043** materiale informative dhe promovuese; kalendari i **prodhuar në 500 kopje** për vitin 2024; Janë realizuar 5 aktivitete për shënimin e rasteve dhe **datave të rëndësishme**.

Për ditën e frankofonisë për herë të dytë u organizua **“Parlamenti frankofon i të rinjve - simulim “Kam qëndrim”**

Si pjesë integrale e Shërbimit të Kuvendit, **Instituti Parlamentar i koordinoi Planin aksional 2024-2026 për Partneritetin për qeverisje të hapur; Programin për mbështetje parlamentare 2024-2027 dhe Planin strategjik të Kuvendit 2025-2029.**

SHTËPI LIGJVËNËSE E INFORMUAR

1. Shtëpi ligjvënës e informuar

1.1 Në vitin 2024 janë dorëzuar 45 kërkesa për hulumtime, nga të cilat 43 kërkesa janë parashtruar nga deputetët, ndërsa 2 kërkesa janë bërë nga sekretari i përgjithshëm. 43 kërkesat e realizuara për punime hulumtuese janë parashtruar nga **28 deputetë të ndryshëm gjithsej ose 23.3% e numrit të përgjithshëm të deputetëve**. Kërkesat e deputetëve në pjesën më të madhe lidhen me çështje të agjendës së Kuvendit.

Tabela 1. Statistika e hulumtimeve me kërkesë të deputetëve

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar dhe të përgjigjura të dorëzuara nga deputetët					Numri i përgjithshëm i deputetëve që kanë dorëzuar kërkesë për hulumtim				
43					28				
Struktura gjinore	Numri i kërkesave nga deputetët		Numri i kërkesave nga deputetët		Struktura gjinore	deputete		deputetë	
	23	53,5%	20	46,5%		14	50%	14	50%
Përkatësia e ¹	Numri i kërkesave nga deputetët maqedonas		Numri i kërkesave nga deputetët shqiptarë		Përkatësia etnike ²	Deputetë maqedonas		Deputetë shqiptarë	
	30	69,8%	7	16,3%		17	60,7%	7	25%
Përkatësia politike	Numri i kërkesave nga shumica parlamentare		Numri i kërkesave nga opozita		Përkatësia politike	Shumica parlamentare		Opozita	
	23	53,5%	20	46,5%		15	53,6%	13	46,4%

Rreth 30% e deputetëve që parashtruan kërkesa kanë paraqitur edhe përgjigje ku shprehin kënaqësinë për analizat e bëra nga Instituti Parlamentar. Deputetët përdorën disa nga analizat e Institutit për të përgatitur propozim zgjidhje ligjore ose për të ndryshuar dhe plotësuar ato ekzistueset. Një pjesë tjetër e analizave krahasuese të Institutit Parlamentar është shfrytëzuar nga deputetët e pushtetit ekzekutiv për përgatitjen e rregulloreve, për ndryshime dhe plotësime të vendimeve, si dhe nga sektori joqeveritar për ndërhyrje dhe përmirësimin e shërbimeve të caktuara që u jepen qytetarëve. Pati gjithashtu disa përmendje referuese gjatë fjalimeve në seancat plenare dhe një gjatë një prezantimi në emisionet debatuese televizive.

¹ 6 kërkesa përkatësisht 13,9% e kërkesave janë dorëzuar nga deputetët përfaqësues të bashkësive të tjera etnike

² 4 deputetë përkatësisht 14,3 nga bashkësi tjetër etnike kanë dorëzuar kërkesë për hulumtim

SHTËPI LIGJVËNËSE E INFORMUAR

- 1.2 Me iniciativë personale Instituti Parlamentar ka përpiluar **20 punime hulumtuese**³. Në punimet hulumtuese me vetiniciativë analizohen tema aktuale dhe tema që lidhen me propozim-ligjet që janë në procedurë kuvendore.
- 1.3 Mandej në periudhën raportuese janë përgjigjur **90 pyetësorë** në suazat e ECPRD-së, IPU-s dhe organizatave dhe parlamenteve të tjera.
- 1.4 Pas përfundimit të zgjedhjeve të 11-ta parlamentare, Instituti Parlamentar organizoi **seancë hyrëse për deputetët e rinj** në Kuvendin maqedonas më 03.06.2024 në ambientet e sallës Boris Trajkovski në prani të **59 deputetëve**, me qëllim të njohjes së deputetëve të rinj me organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, kompetencat e tyre legjislative, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese, cilat janë të drejtat dhe detyrimet e tyre, transparencja dhe hapja për publikun e Kuvendit, Kodi i Sjelljes Etike të deputetëve, format e bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe njohje me mjetet elektronike në dispozicion të Kuvendit, duke e përfshirë zbatimin e tyre praktik në sistemin e votimit në sallën plenare.
- 1.5 Në kuadër të aktiviteteve, Instituti Parlamentar, së bashku me Shërbimin e Kuvendit, ofruan **10 trajnime** me tema të ndryshme për deputetët e rinj të Kuvendit duke filluar nga data **17 qershor deri më 28 qershor 2024**. Në këto trajnime morën pjesë **gjithsej 8 deputetë**. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte njohja më e detajuar e deputetëve me funksionin dhe punën e Kuvendit.
- 1.6 Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara, Instituti Parlamentar zhvilloi **Trajnimin hyrës për të punësuarit e rinj në Shërbimin e Kuvendit** si punëtori njëditor më **15 shkurt 2024**, për **11 të punësuar të rinj** në Kuvend me qëllim që të njihen me organizimin dhe funksionimin e Kuvendit si dhe njohjen me procesin e detyrave të punës dhe njohjen me fushëveprimin e punës së Shërbimit të Kuvendit.
- 1.7 **Më 11 prill 2024**, Instituti Parlamentar organizoi seminar treditör për Shërbimin Parlamentar me temë: **“Zbatimi i Rregullores së Kuvendit”** ku morën pjesë **33 të punësuar të shërbimit parlamentar në Gjevgjeli** që të njihen me ndryshimet ligjore dhe procedurale në punën e deputetëve në komisione, seanca, seancë konstituive, pyetje parlamentare, duke përfshirë edhe kalendarin dhe dinamikën e punës së Kuvendit.
- 1.8 Instituti Parlamentar mbajti punëtorinë e dytë për Shërbimin e Kuvendit nga data **18-20 prill 2024** në **Krushevë** në prani të **42 të punësuarve** në Shërbimin e Kuvendit me temë: **“Organizimi i seancës hyrëse për deputetët e sapozgjedhur”**, me qëllim që të ndërmerren aktivitetet përgatitore për organizimin e Seancës hyrëse për deputetët e rinj në mandatin e ri parlamentar.

³ Punimet hulumtuese me iniciativë personale janë në dispozicion të publikut në ueb-faqen e Kuvendit në linkun në vijim: http://www.sobranie.mk/aktivnosti-na-parlamentarniot-institut-ns_article-istrazuvalcki-raboti-po-sopstvena-inicijativa-na-parlamentarniot-institut-2024-godina.nspix

SHTËPI LIGJVËNËSE E INFORMUAR

- 1.9 Si një nga trajnimet e organizuara nga Instituti Parlamentar dhe i zhvilluar me temë: **“Përlllogaritjet tabelare dhe grafikët - Microsoft Excel”** në prill 2024, **33 të punësuarve** të Shërbimit të Kuvendit u janë dhënë certifikata.
- 1.10 Instituti Parlamentar mbajti **“Punëtorinë për përgatitjen e Propozim-planit strategjik të Kuvendit 2025-2029”** nga data **16-17 korrik 2024 në Veles**, në prani të **31 pjesëmarrësve** nga Shërbimi i Kuvendit, së bashku me NDI Maqedoni.
- 1.11 Sipas Planit të punës së Institutit Parlamentar për vitin 2024, në nëntor 2024 vazhdoi mësimi i **gjuhës maqedonase të shenjave** për deputetët dhe të punësuarit në Shërbimin e Kuvendit, me mbështetje financiare nga NDI Maqedoni. Ky kurs ndahet në dy nivele, bazë dhe i avancuar, në të cilin morën pjesë gjithsej **34 pjesëmarrës**, nga të cilët në nivelin bazë morën pjesë gjithsej **23 pjesëmarrës**, përkatësisht **5 deputete**, dhe në kursin e avancuar, **11 pjesëmarrës**, duke përfshirë edhe **2 deputete**, me qëllim për gjithëpërfshirje më të madhe të të gjithë qytetarëve, veçanërisht në Kuvend.
- 1.12 Pas procedurës së zbatuar për **furnizim publik me gazeta ditore dhe javore** më 18.10.2023 u lidh Marrëveshja me Shoqërinë për shpërndarje, tregti dhe shërbime Kolporter SHPK Shkup, në përputhje me të cilën Kuvendi, në dy vitet në vijim (që më 4.11.2023) i merr këto gazeta dhe revista:
1. Nova Makedonija - 15 numra
 2. Veçer - 15 numra
 3. Slloboden pečat - 16 numra
 4. Lajm - 5 numra
 5. Koha - 6 numra
 6. Fokus (javore) - 16 numra
 7. Ekonomija i Biznis (mujore) - 2 numra
 8. Lice v lice (periodike) - 12 numra.
- 1.13 Kuvendi është abonuar dhe merr **10 ekzemplarë të botimit të shtypur të “Gazetës Zyrtare”**. Për nevojat e deputetëve dhe të Shërbimit të Kuvendit, Instituti Parlamentar është abonuar në tri baza elektronike të dhënash – **Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Akademika, De Jure dhe Praksis**. Në bazën elektronike të të dhënave të **“Gazetës Zyrtare”** janë abonuar **49 përdorues** deri më 13.02.2025, **29 përdorues** deri më 15.8.2025.
- 1.14 Fondi bibliotekar është i unifikuar dhe është në dispozicion për deputetët dhe përdoruesit e tjerë. Janë përpunuar, regjistruar dhe futur në sistemin e-bibliotekës **14.857** libra, të njëjtit janë shpërndarë në vitrinat në ambientet e Institutit Parlamentar dhe në korridoret e ndërtesës së Kuvendit. Tek katalogu elektronik qasja është nëpërmjet faqes: < <http://biblioteka.sobranie.mk/General/Books.aspx>>, ku çdo përdorues mund të ketë qasje me emrin e vet të përdoruesit dhe me fjalëkalimin e vet me të cilin futet në sistemin e-parlament.

SHTËPI LIGJVËNËSE E INFORMUAR

1.15 Gjatë vitit 2024, nga biblioteka janë huazuar **115 tituj**, nga të cilët 26 libra janë marrë nga deputetë, 86 nga të punësuarit e Kuvendit, ndërsa 2 janë marrë nga vullnetarë dhe 1 nga një asistent i grupit politik.

1.16 Gjatë vitit 2024 janë përpiluar **dhjetë hulumtime tematike nga fondi bibliotekar** të cilin e posedon biblioteka:

- Krimi i organizuar
- Psikologjia
- Llojet e ndryshme të ekonomisë
- Teknologji informatike dhe të komunikimit

Hulumtimet tematike janë në sistemin RMS të Institutit Parlamentar, në leximoren e bibliotekës hulumtuese si dhe në raftet nëpër ndërtesën e Kuvendit së bashku me materialet e tjera të Institutit Parlamentar.

2. Kuvendi për të gjithë

- 2.1 Në mbledhjen e Këshillit Drejtues më 17 janar 2024, janë propozuar dhe miratuar Plani vjetor për edukim dhe komunikim specifik me publikun për vitin 2024 dhe Plani vjetor për zbatim të trajnimeve nga Instituti Parlamentar për vitin 2024. Këto dy plane, janë baza e zbatimit të aktiviteteve për edukim dhe informim të qytetarëve, si edhe të deputetëve dhe të punësuarve në Shërbimin e Kuvendit, të bashkëpunëtorëve të jashtëm të grupeve parlamentare dhe të asistentëve në zyrat për komunikim me qytetarët.
- 2.2 Në përputhje me planet për edukim dhe komunikim specifik me publikun, Instituti Parlamentar gjatë vitit 2024 organizoi dhe zbatoi seminare dhe punëtori edukative për këto grupe qëllimore:
- dy seminare edukative njëditore, me temë “Demokracia dhe Kuvendi” për nxënësit e shkollave të mesme, gjithsej **56 pjesëmarrës**, nxënës dhe arsimtarë;
 - njëzet e dy punëtori edukative për nxënësit e shkollave të mesme në formë simulimi (lojë rolesh) të quajtura “Kam qëndrim!”, gjithsej **533 pjesëmarrës**, nxënës nga 19 shkolla të mesme;
 - punëtori edukative për nxënësit e shkollave nëntëvjeçare në Republikën e Maqedonisë së Veriut të quajtura “Parlamenti i fëmijëve”, gjithsej **79 pjesëmarrës**, nxënës dhe arsimtarë.
 - dy seminare interaktive njëditore për studentë me titull “Parlamenti (Kuvendi) si institucion themelor i të drejtës parlamentare” me gjithsej **63 studentë dhe profesorë**;
 - punëtori për arsimtarët për arsim qytetar nga shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjithsej **91 pjesëmarrës** nga shkollat nëntëvjeçare;

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur **30 punëtori dhe seminare edukative** kushtuar nxënësve të shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme, studentëve dhe mësimdhënësve në arsimin nëntëvjeçar dhe të mesëm. Në eventet edukative me **822 pjesëmarrës gjithsej** u përfshinë edhe **49 deputetë nga parti të ndryshme politike**.

- Seminari edukativ “Demokracia dhe Parlamenti” - në seminarin e parë që u mbajt më **22 prill**, morën pjesë **25 pjesëmarrës** nga 5 shkolla të mesme nga 3 qytete të ndryshme, kurse seminari i dytë u mbajt më **17 shtator**, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Demokracia, në të morën pjesë nxënës nga 6 shkolla të mesme nga 4 qytete të ndryshme me gjithsej **31 pjesëmarrës**.
- Punëtoritë edukative “Kam qëndrim!” - Punëtoritë në kuadër të “Kam Qëndrim!” u realizuan në dy sezone, në ciklin e parë duke filluar nga **20 shkurti deri më 6 mars 2024** garuan 9 shkolla nga Velesi, Tetova, Koçani, Kumanova, Demir Hisar dhe Bogdanci, me gjithsej **301 nxënës dhe mësimdhënës**. Në këtë sezon morën pjesë gjithsej **15 deputetë** nga grupe të ndryshme politike si anëtarë të jurisë për të vlerësuar debatet dhe pikëpamjet e pjesëmarrësve. Më 27 mars 2024 u mbajt manifestimi final “Kam qëndrim” në praninë e 70 nxënësve dhe

mësimdhënësve në juri prej **katër deputetësh** dhe një i punësuar në Institutin Parlamentar, kurse nxënësit nga SHMQSH “Vasil Antevski-Dren” nga Shkupi mori trofeun për vendin e parë. Në sezonin e dytë të aktivitetit edukativo-arsimor “Kam qëndrim!”, për vendin e parë, të dytë dhe të tretë për oratorët më të mirë konkurruan nëntë shkolla të mesme nga Shkupi, Kavadari, Krusheva, Kumanova, Ohri dhe Shtipi, me gjithsej **232 nxënës dhe mësimdhënës**, kurse ata u ndoqën dhe u vlerësuan nga **18 deputetë gjithsej**, me pjesëmarrjen shtesë të **pesë deputetëve** të tjerë në evenimentin final të “Kam qëndrim!”. Ky sezon filloi më **15 tetor dhe zgjati deri më 4 nëntor 2024**. Më 19 dhjetor 2024, manifestimi final i “Kam Qëndrim” u fitua nga nxënësit e shkollës së mesme SHMK “Rade Jovčevski - Korçagin” nga Shkupi.

- Punëtori edukative Parlamenti i Fëmijëve - Punëtorja u organizua më **20 nëntor 2024** me rastin e Ditës Botërore të Fëmijëve dhe në të morën pjesë gjithsej **79 nxënës dhe mësues** nga 15 shkolla nëntëvjeçare nga i gjithë vendi. Qëllimi i këtij aktiviteti është që nëpërmjet simulimit të procedurës ligjvënëse të rinjve t’u afrohet puna e Kuvendit, të kontribuojë në zhvillimin e vetëdijes demokratike dhe kulturës së tolerancës, si edhe të nxiten të rinjtë për kritikizëm dhe përfshirje shoqërore dhe politike. Në këto punëtori **morën pjesë edhe tre deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare** në Kuvend kështu që nxënësit kishin një mundësi jo të përditshme që të bisedojnë me deputetët dhe t’u parashtrojnë pyetje. Me mesazhin e sivjetshëm të UNICEF-it, “Dëgjo të Ardhmen!”, nxënësit krijuan postera kreativë me mesazhe drejtuar deputetëve dhe të rriturve në formë vizatimesh dhe vargjes, nga të cilët u krijua kalendari 2025 për Parlamentin. Seminari për studentët - tri seminarët me titull pune “Parlamenti (Kuvendi) si institucioni themelor i të drejtës parlamentare” janë realizuar më **16 tetor dhe më 11 dhjetor** dhe morën pjesë **63 studentë dhe profesorë gjithsej** nga 4 universitete të ndryshme. Në seminar morën pjesë edhe **katër deputetë** nga grupe të ndryshme parlamentare në Kuvend dhe studentëve ua përcollën përvojën e tyre praktike në kryerjen e funksionit parlamentar.
- Punëtori për arsimtarët për arsim qytetar nga shkollat nëntëvjeçare - Me rastin e festimit të Ditës Botërore të Mësuesit, Instituti Parlamentar, së bashku me NDI Maqedoni, më **4 tetor 2024** në sallën Boris Trajkovski mbajti punëtori njëditore për mësimdhënësit e shkollave nëntëvjeçare, në prani të gjithsej 121 pjesëmarrësve nga të cilët **91 mësues** nga qytete dhe zona rurale të Maqedonisë.

2.3 Për të promovuar kulturën e hapjes së dhomës ligjvënëse, Instituti Parlamentar realizon **vizita të organizuara në ndërtesën e Kuvendit** për të gjithë qytetarët e interesuar. Në vitin 2024, **10.266 qytetarë** ishin pjesë e **230 vizitave të organizuara** në Kuvend. **Numri i vizitave të organizuara dhe numri i pjesëmarrësve në vitin 2024 është një arritje rekorde**, përkatësisht numri më i madh i vizitave dhe pjesëmarrësve deri më tani brenda një viti kalendarik. Vizitat e organizuara u realizuan me prani fizike të pjesëmarrësve në ndërtesën e Kuvendit. Nëpërmjet vizitave që zgjasin një orë, qytetarët kanë një mundësi të pazakontë për të parë ndërtesën e Kuvendit dhe për të parë se ku punojnë deputetët.

KUVENDI PËR TË GJITHË

Në lidhje me llojin e terminit të vizitave, 9.423 (91.79%) pjesëmarrës ka pasur në vizitat me prani fizike të pjesëmarrësve, vetëm një vizitë onlajn me 25 pjesëmarrës, ndërsa gjatë vizitave që mbahen në kuadër të seminareve/vebinarëve edukativë kanë marrë pjesë 818 (7.97%) pjesëmarrës.

Tabela 2. Pasqyrë e pjesëmarrësve të vizitave sipas llojit të terminëve për vizitë në vitin 2024

Iloji i terminit për vizitë	numri i vizitave	numri i pjesëmarrësve
Vizita me prani fizike të vizitorëve	199	9.423
Vizita onlajn	1	25
Vizita të organizuara në kuadër të seminareve edukative	30	818
Gjithsej	230	10.266




Sa u përket grupeve të synuara të përfshira me vizita, numri më i madh i pjesëmarrësve (7,277 ose pothuajse dy të tretat e numrit të përgjithshëm) ishin nxënës dhe mësimitdhënës të shkollave fillore. Nxënësit dhe mësimitdhënësit e shkollave të mesme kanë një peshë të madhe në numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve (1.437).

Tabela 3. Pasqyrë e pjesëmarrësve në Kuvend sipas llojit të pjesëmarrës në vitin 2024

Iloji i pjesëmarrësve	numri i vizitave	numri i vizitorëve
nxënës dhe mësimitdhënës të shkollave fillore	128	7.277
nxënës dhe mësimitdhënës të shkollave të mesme	34	1.437

KUVENDI PËR TË GJITHË

studentë	8	228
fëmijë dhe mësimdhënës nga mosha parashkollore	1	50
të ftuar të deputetëve dhe delegacione të huaja	17	101
grupe të anëtarëve të organizatave civile	12	310
të tjerë	30	863
Gjithsej	230	10.266




Në lidhje me gjuhën në të cilën janë realizuar vizitat, numri më i madh i vizitave kanë qenë në gjuhën maqedonase (82,41% nga numri i përgjithshëm), 37 kanë qenë në shqip ose me përkthim në gjuhën shqipe (13.20%), 22 vizita në anglisht (4,05%), kurse një vizitë kanë qenë onlajn në gjuhën maqedonase.

Tabela 4. Pasqyrë e numrit të vizitave në vitin 2024 sipas gjuhës në të cilën janë mbajtur vizitat

Gjuha në të cilën realizohet vizita	numri i vizitorëve
në gjuhën maqedonase	8.460
në maqedonisht me përkthim në anglisht	416
në gjuhën shqipe	939
në gjuhën angleze	416
Vizitë onlajn në gjuhën maqedonase	25
në maqedonisht me përkthim në anglisht	10
Gjithsej	10.266

KUVENDI PËR TË GJITHË




Sa i përket periudhës së vitit, më shumë pjesëmarrës gjatë vizitave janë vërejtur në muajt prill (1.656) dhe nëntor (1.641), ndërsa më pak pjesëmarrës kanë pasur në muajt korrik (13) dhe gusht (46).

Tabela 5: Pasqyrë e numrit të vizitorëve në Kuvend në vitin 2024 sipas muajve

Muaji	numri i vizitave	numri i vizitorëve
Janar	4	68
Shkurt	27	1.091
Mars	28	1.372
Prill	30	1.656
Maj	16	733
Qershor	12	637
Korrik	3	13
Gusht	2	46
Shtator	13	587
Tetor	26	1.093
Nëntor	38	1.641
Dhjetor	31	1.329
GJITHSEJ	230	10.266

KUVENDI PËR TË GJITHË



Në lidhje me përfaqësimin rajonal të vizitorëve në vitin 2024 Kuvendin e kanë vizituar qytetarë nga **39** vende të ndryshme banimi në shtet, prej të cilave **22** qytete të ndryshme dhe **17** mjedise të ndryshme rurale.

2.4 Gjatë vitit u zbatua **përgatitja, shtypja dhe shpërndarja e vazhdueshme e materialeve të Institutit Parlamentar**. Në vitin 2024 janë **shtypur gjithsej 7.043 materiale promovuese dhe informative që u janë shpërndarë** grupeve përkatëse qëllimore.

2.5 Vizatimet dhe mesazhet e pjesëmarrësve në “Parlamentin e fëmijëve” të mbajtur në dhjetor janë përdorur për përpilimin e **kalendarit për vitin 2025**, i cili është shtypur në 550 ekzemplarë dhe është shpërndarë për promovim të Institutit Parlamentar dhe të pushtetit ligjvënës.

2.6 Në përputhje me Planin vjetor, Instituti Parlamentar bëri organizim dhe zbatim të **aktiviteteve për festimin e ngjarjeve dhe datave të rëndësishme**. Gjatë vitit 2024 janë festuar këto ngjarje dhe data të rëndësishme:

- **15 Shtatori:** Dita Ndërkombëtare e Demokracisë - **seminar edukativ i organizuar** në Kuvend për nxënësit e shkollave të mesme:
- **15 Shtatori:** Dita Ndërkombëtare e Demokracisë - Instituti Parlamentar, në bashkëpunim me NDI Maqedoni, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë, organizoi manifestim më 17 shtator 2024 në prani të 220 nxënësve dhe mësimitdhënësve nga shkollat nëntëvjeçare dhe të mesme të Shkupit në Sallën e kristaltë. Në këtë aktivitet

mori pjesë një grup aktorësh nga Tim-Theatros të cilët nëpërmjet pantomimës shprehën kuptimin e konceptit të demokracisë për të ftuarit e pranishëm.

- **5 Tetor** Dita botërore e mësimdhënësive - **punëtori edukative e organizuar** në Kuvend me mësimdhënës të arsimit të nëntëvjeçar;
- **20 Nëntori:** Dita Botërore e Fëmijëve - punëtori edukative e organizuar në Kuvend Parlamenti i Fëmijëve për nxënësit e shkollave nëntëvjeçare;
- **3 Dhjetori:** Në kuadër të festimit të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, IP organizoi vizitë për shoqatën për fëmijë me nevoja të veçanta “E dua ylberin”.

- 2.7 Për të dytin vit me radhë, u mbajt tradicionalisht evenimenti **Parlamenti i të Rinjve Frankofonë – një simulim i “Kam qëndrim!”** më 7 mars 2024 në frëngjisht. Aktiviteti u organizua me rastin e Ditëve të Frankofonisë, nga Instituti Parlamentar në bashkëpunim me Sektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Kuvend dhe MPJ-në. Në total morën pjesë **78 nxënës dhe mësues të shkollave të mesme** të qyteteve: Shkup, Negotinë, Manastir, Kumanovë dhe Tetovë. Nxënësit diskutuan dhe debatuan mbi tri tema të ndryshme në gjuhën franceze.
- 2.8 Në periudhën raportuese, Instituti Parlamentar ka vazhduar me praktikën e vendosur **të raportimit të evenimenteve të tij** nëpërmjet mjeteve elektronike. Pas realizimit të çdo evenimenti, informacioni për të publikohet në faqet zyrtare të Institutit në rrjetet sociale, si dhe në faqen e internetit të Kuvendit.

Në kontekst të promovimit të hapjes, transparencës dhe llogaridhënies, Instituti Parlamentar vazhdimisht gjatë gjithë vitit i **publikoi punimet hulumtuese të përgatitura me iniciativën e tij për vitin 2024**, në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit. Ato gjenden në linkun e mëposhtëm: https://www.sobranie.mk/aktivnosti-na-parlamentarniot-institut-ns_article-istrazuivacki-raboti-po-sopstvena-inicijativa-na-parlamentarniot-institut-2024-godina.nspix

3. Institut Parlamentar bashkëkohor

- 3.1 Instituti Parlamentar **organizoi** seminarin e ECPRD-së të mbajtur në Shkup më **26 dhe 27 shtator 2024**, me temën **“Kalendarët Parlamentarë dhe Planifikimi i Agjendës”, fushë e interesit - Praktika dhe Procedura Parlamentare; Parliamentary calendars and agenda planning, Area of interest – Parliamentary practice and procedure**. Në seminar morën pjesë përfaqësues nga shërbimet e Austrisë, Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar, Spanjës, Hungarisë, Portugalisë, Shqipërisë etj. Qëllimi i ngjarjes është të ofrojë njohuri dhe përvoja krahasuese në lidhje me planifikimin e agjendës legjislative dhe kalendarit të seancave plenare dhe trupave punues, me qëllim të: sigurimit të parashikueshmërisë, ndërgjegjësimit të publikut, kohës për analiza dhe vlerësime të ndikimit të rregulloreve, planifikimit të instrumenteve mbikëqyrëse, planifikimit të aktiviteteve vendase dhe ndërkombëtare, etj.
- 3.2 Gjashtë të punësuar e shfrytëzojnë mundësinë për ngritje profesionale, tre të punësuar në studime pasuniversitare, dy të punësuar në studime të doktoratës dhe një e punësuar për trajnim të specializuar.
- 3.3 Për të matur **shkallën e kënaqësisë së përdoruesve të shërbimeve** të Institutit Parlamentar, kryhet **evaluim i evenimenteve edukative** pas përfundimit të tyre, mandej përpilohet **Analizë e evaluimit dhe Raport me përfundime dhe rekomandime**, të cilat merren parasysh gjatë përpilimit të Planit vjetor dhe gjatë revizionit të programeve të evenimenteve edukative.
- 3.4 Në periudhën raportuese, vazhdoi bashkëpunimi onlajn i Institutit Parlamentar në kuadër të **Federatës Ndërkombëtare dhe Asociacionit të Bibliotekave IFLA, Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave (ICA), Forumit Ndërkombëtar të Qendrave Parlamentare për Qasjen e Parlamenteve dhe Qendrës Evropiane për Hulumtime Parlamentare dhe Dokumentim (ECPRD)**.
- 3.5 Në bashkëpunim me qendrën hulumtuese të Dhomës së Lordëve të Mbretërisë së Bashkuar dhe Universitetin në Lids, **Instituti Parlamentar u bë anëtar i Rrjetit Ndërkombëtar për Aksion Parlamentar <https://ipen-network.org/>** qëllimi i të cilës është zhvillimi i rrjetit ndërkombëtar të ekspertëve dhe profesionalistëve në lidhje me efikasitetin dhe ndikimin e programeve për përfshirje të publikut në parlamente.

4. Parlament digjital

- 4.1 Instituti Parlamentar ka në dispozicion platforma softuerike për disa procese pune: E-arkivi, E-biblioteka dhe RMS, e-sistemet për regjistrimin e qytetarëve, kuiz edukativ, vizitë virtuale, E-seminare dhe E-trajnime. Mandej, të punësuarit përdorin licenca për programet canva dhe abode për përpunim grafik. Të gjitha sistemet ishin lëndë e mirëmbajtjes parandaluese. Nëpërmjet këtyre shërbimeve bëhet mirëmbajtje cilësore dhe në kohë e zgjidhjeve të zbatueshme dhe bazave të të dhënave të sistemit informativ. Mandej, lëndë mirëmbajtjes parandaluese janë panelet e brendshme dhe të jashtme për informim. Për të mbështetur procesin e përkthimit dhe përdorimin e gjuhëve, në vitin 2024 u rinovuan licencat për përdorimin e platformës softuerike Trados për disa sektorë në Parlament.
- 4.2 Instituti Parlamentar ka parashikuar procedurën për digjitalizimin e procesit të përgatitjes së raporteve dhe statistikave të Kuvendit në vitin 2024. Të punësuarit kanë hartuar specifikim teknik dhe ai do të publikohet në janar të vitit 2025.
- 4.3 Instituti Parlamentar e mbyll vitin 2024 me të punësuar 13 gjithsej nga gjithsej 29 të punësuar të planifikuar sipas sistematizimit. Për zgjidhjen e mungesës së të punësuarve për shkak të largimeve apo avancimeve në sektorë të tjerë të shërbimit, në dhjetor 2024 u publikua shpallje për plotësimin e 4 pozicioneve të punës.
- 4.4 Nga buxheti i përgjithshëm i planifikuar i Institutit për vitin 2024 prej 8,3 milionë denarë, realizimi është 6,9 milionë denarë për të gjitha aktivitetet e realizuara. Nga shpenzimet operative dhe sipas buxhetit të miratuar për vitin 2024, janë shpenzuar për udhëtim dhe akomodim jashtë vendit, mirëmbajtje softuerike dhe harduerike me tri kontrata, ushqime për vizitorë (kafe, ujë dhe ushqime), shërbime kontraktuale (botime, përkthime, akses në baza të të dhënave etj.) ose gjithsej 0.6% të buxhetit vjetor të Kuvendit.

Zlatko Atanasov
Këshilltar shtetëror i
Institutit Parlamentar